



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS DEÇAN

Numri i lëndës: 2022:127885

Datë: 05.03.2024

Numri i dokumentit: 05410899

C.nr.504/2022

GJYKATA THEMELORE NE PEJË, Dega në Deçan, Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtari Bajram Cacaj, duke vendosur në çështjen juridike kontestimore të paditësit B. M., nga fshati Ll. e E., K. e D., të cilin sipas autorizimit e përfaqëson D. C., avokat në D., kundër të paditurës Komuna e Deçanit, Drejtoria Komunale e Arsimit, me seli në Deçan, lidhur me çështjen juridike kompensim i shpenzimeve të udhëtimit në punë, kompensim i shpenzimeve të shujtave në punë dhe kompensim i pagës mbi bazën e inflacionit, jashtë seancës me datë 05.02.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

- Për shkak të padëgjueshmërisë/mosbindjes –

APROVOHET kërkesëpadia e paditësit B. M., ashtu që DETYROHET e paditura Komuna e Deçanit, Drejtoria Komunale e Arsimit, t'ia paguaj paditësit shumat si në vijim:

- në emër të kompensimit për udhëtim gjatë punës për periudhën prej datës 01.11.2021 e deri më datën 30.10.2022 për 193 ditë punë, shumën prej 270,20 €,

- në emër të kompensimit për shujta gjatë punës për periudhën prej datës 01.11.2021 e deri më datën 30.10.2022 për 193 ditë punë, shumën prej 386,00 € dhe

- në emër të kompensimit shtesë - përqindjes së inflacionit shumën prej 167,49 €, shumë kjo e cila i referohet periudhave si në vijim:

- për periudhën janar-dhjetor 2020 shumën prej 10,08 € dhe

- për periudhën janar-nëntor 2021 shumën prej 157,41 €,

e në shumë të përgjithshme shumën prej 823,69 €, me kamatë ligjore prej 8 %, e cila do të llogaritet nga data 22.06.2022 (data e paraqitjes së padisë), e deri në ditën e pagesës definitive, si dhe shpenzimet e procedurës në shumë prej 228,00 €, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, e nën kërcënim të përbarimit me ligj.

A r s y e t i m

Paditësi në këtë gjykatë përmes të autorizuarit të tij, me padinë e datës 22.06.2022 dhe parashtresën për precizimin e kërkesëpadisë të datës 01.03.2024 të ushtuar kundër të paditurës Komuna e Deçanit, Drejtoria Komunale e Arsimit, ka kërkuar që të obligohet e paditura, që paditësit në emër të kompensimit për udhëtim gjatë punës për periudhën prej datës 01.11.2021 e deri më datën 30.10.2022 për 193 ditë punë, t'i paguaj shumën prej 270,20 €, në emër të kompensimit për shujta gjatë punës për periudhën prej datës 01.11.2021 e deri më datën 30.10.2022 për 193 ditë punë, t'i paguaj shumën prej 386,00 € dhe në emër të kompensimit shtesë - përqindjes së inflacionit për vitet 2020 dhe 2021 t'i paguaj shumën prej 167,49 €, apo shumën e përgjithshme për udhëtim, shujta dhe inflacion 823,69 €, me kamatë ligjore prej 8 %, e cila do të llogaritet nga dita e paraqitjes së padisë, e deri në ditën e pagesës definitive, si dhe shpenzimet procedurale, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, nga dita e marrjes së aktgjykimit, e nën kërcënim të përmbarrimit me ligj.

Gjykata në këtë çështje juridike kontestimore, pas shqyrtimit paraprak të padisë, ka nxjerrë aktvendimin për përgjigje në padi, C.nr.504/2022 të datës 19.09.2023, me të cilin e ka detyruar të paditurën, që të përgjigjet në padi, të cilin e paditura e ka pranuar me datë 02.10.2023, duke e njoftuar të paditurën për detyrimin ligjor për dhënien e përgjigjes në padi dhe për pasojat ligjore që do të i ketë nëse nuk paraqet përgjigje në padi, përkatësisht për mundësinë që gjykata të marrë aktgjykim për shkak të mosbindjes.

E paditura pavarësisht se e kanë pranuar aktvendimin për përgjigje në padi, së bashku me padinë dhe provat materiale në këtë çështje juridike kontestuese, nuk ka paraqitur përgjigje në padi brenda afatit ligjor.

Gjykata pasi i ka vlerësuar kushtet ligjore për nxjerrjen e aktgjykimit për shkak të mos bindjes, ka gjetur se në rastin konkret, plotësohen të gjitha kushtet ligjore, për nxjerrjen e aktgjykimit në fjalë, nga neni 150 par. 1, pikat a), b) dhe c) të LPK-së, e cila dispozitë në mënyrë shprehimore parasheh se: *“Nëse të paditurit i është dorëzuar padia dhe thirrja për përgjigje në padi, se themelësia e kërkesëpadisë del nga faktet treguara në padi dhe se faktet në të cilat mbështet kërkesëpadia, nuk janë në kundërshtim me provat të cilat i ka propozuar vet paditësi, apo me faktet e ditura botërisht”*.

Gjykata nga provat të cilat i janë bashkëngjitur padisë dhe atë: kontrata e punës e lidhur në mes të paditësit dhe këtu të paditurës, me datë të protokollit 13.09.2021, vërtetimi i datës 10.01.2022, vërtetimit për ditët e prezencës në punë për periudhën nga data 01.11.2021 e deri më datë 30.10.2022, vërtetimi i lëshuar nga Kompania “K. T.”, me numër ../. i datës 21.06.2022 dhe lista e pagave e lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës për paditësin, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësi për këtë periudhë ka qenë i punësuar tek e paditura, po ashtu ka vërtetuar saktë numrin prej 193 ditëve të prezencës në punë për periudhën e kërkuar, lartësinë e biletës se udhëtimit prej 2 (dy) € në dy drejtimet për relacionin e kërkuar, po ashtu ka vërtetuar se paga bazë për të njëjtin gjatë viteve 2021 dhe 2022 ka qenë 421 €. Po ashtu, gjykata bazuar në Indeksin e Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit i publikuar nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, ka vërtetuar se shkalla e inflacionit për vitin 2020 ka qenë 0.2%, ndërsa për vitin 2021 ka qenë 3.4%.

Gjykata gjen se në rastin në fjalë duhet të zbatohen dispozitat e dy Kontratave Kolektive të Arsimit në Kosovë (KKAK), të nënshkruar në mes të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, asaj të vitit 2017 (e aplikueshme nga data 18.04.2017-21.01.2021) dhe asaj të vitit 2021 (e aplikueshme nga data 22.01.2021-22.11.2022), ku në nenin 35 par. 5 të këtyre kontratave është përcaktuar se “*Punonjësit arsimor që udhëtojnë në vendbanimet e komunës përkatëse ku punojnë i paguhen shpenzimet e rrugës për 70% të biletave të trafikut urban*”, ndërsa me paragrafin 7 të të njëjtit nen është përcaktuar se: “*Të punësuarve iu njihet e drejta për ushqim gjatë punës për ditët e pranisë në punë, vlera e kompensimit të ushqimit për një ditë të pranisë në punë, është 2 (dy) euro për të punësuarit që kanë marrëdhënie primare të punës në institucionet arsimore. Punëdhënësi i cili ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve përmes restaurantit apo kuzhinës, apo ndonjë forme tjetër nuk e ka obligim pagese (2 euro), të të punësuarve për ushqim për t’u bërë kompensimin.*”, e po ashtu me paragrafin 10 të të njëjtit nen përcaktohet se “*Për çdo vit të përcillet shkalla e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës dhe përqindja (%) e inflacionit të futet në pagë*”, ashtu që gjykata erdhi në përfundim se në rastin konkret paditësit i takon e drejta në pagesën e shpenzimeve të udhëtimit në punë, e drejta në pagesën e shpenzimeve të shujtave në punë dhe pagesën mbi bazën e përqindjes së inflacionit, si në dispozitivit të këtij aktgjykimi, pasi që dispozitat e tilla janë të karakterit imperativ dhe si të tilla do të duhej që shpenzimet e udhëtimit dhe të shujtave të kompensohen dhe shkalla e inflacionit të llogaritet në pagë, marrë parasysh që nga lista e pagave që gjendet në shkresat e lëndës, nuk rezulton që një pagesë e tillë është kryer nga e paditura.

Sa i përket lartësisë së kërkesë padisë lidhur me kompensimin e shpenzimeve për udhëtim në punë gjykata aplikoi dispozitën e lartcekur pasi vërtetoi se çmimi i biletës për relacionin e kërkuar është 2,00 (dy) €, në dy drejtimet, gjykata ia llogariti 70% të çmimit të biletës, ashtu që për 193 ditë të pranisë në punë, paditësit në emër të kompensimit të shpenzimeve të udhëtimit ia njohu shumën prej 270,70 €, ndërsa në emër të kompensimit për shujta në punë, gjykata bëri përlllogaritjen në atë mënyrë që ditët e kaluara në punë të paditëses i ka shumëzuar me 2 (dy), duke ia njohur shumën prej 386,00 €.

Ndërsa sa i përket lartësisë së kërkesëpadisë lidhur me kompensimin në pagë mbi bazën e inflacionit, gjykata vendosi duke pasur parasysh të dhënat e nxjerra nga Enti i Statistikave të Kosovës sa i përket shkallës mesatare vjetore të inflacionit, sipas përlllogaritjes si në vijim:

- Për periudhën janar-dhjetor 2020, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 0.2%, andaj duke e llogaritur pagën bazë të paditësit e cila në vitin 2020 ka qenë 421,00 €, atëherë i bie që shuma e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë për periudhën 12 mujore në total të jetë 10,08 €, apo 0,84 € për muaj ($421 \cdot 0.2\% \cdot 12 = 10,08$) dhe

- Për periudhën janar-nëntor 2021 (brenda kërkesës së palës), gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 3.4%, andaj duke e llogaritur pagën bazë të paditësit e cila në vitin 2021 ka qenë 421,00 €, atëherë i bie që shuma e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë për periudhën 11 mujore në total të jetë 157,41 €, apo 14,31 € për muaj ($421 \cdot 3,4\% \cdot 11 = 157,41$).

Edhe pse përlllogaritja e përqindjes së inflacionit duhet të bëhet sipas shtimit dinarik ndër vite, gjykata në rastin konkret vendosi si në dispozitiv brenda kufijve të kërkesës së palës konform nenit 2.1 të LPK i cili përcakton se: *“Në procedurë kontestimore gjykata vendos brenda kufijve të kërkesave që janë parashtruar nga palët ndërgjyqëse”*.

Andaj, gjykata vlerëson se nga provat e lartcekura del baza dhe lartësia e kërkesëpadisë, andaj në kuptim të nenit 150 i LPK-së, e në lidhje me dispozitat nga neni 245 paragrafi 1 i Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD), ku përcaktohet se: *“Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbushë atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij”*, erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paraqitur nga ana e paditësit është e bazuar dhe në këtë rast e njëjta u aprovua në tërësi si e themeltë, duke obliguar të paditurën në pagimin e obligimit sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Lartësia e kamatës së përcaktuar prej 8%, i referohet nenit 382 të LMD-së dhe kamata është llogaritur nga dita e parashtrimit të padisë.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale u mor në kuptim të nenit 449 dhe 452 të LPK-së, ashtu që palës paditëse në emër të shpenzimeve iu pranua shuma prej 20,00 €, e cila i referohet taksës gjyqësore të paguar për padi, shuma prej 104,00 € në emër të përpilimit të padisë, si dhe shuma prej 104 € në emër të përpilimit të precizimit të kërkesëpadisë, e në shumë të përgjithshme prej 228,00 €.

Prandaj, gjykata bazuar në arsyet e cekura më lartë, bazuar në nenin 143 lidhur me nenin 150 par.1 të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË

Dega në Deçan

C.nr.504/22, me datë 05.03.2024

G J Y Q T A R I

Bajram Cacaj

UDHËZIM JURIDIK:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afatin prej 7 ditëve, nga dita e marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit të Kosovës, e nëpërmjet kësaj gjykate. Ankesa duhet të paraqitet në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.